



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:177197

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05516984

CAP.nr.1554/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, gjykatësi individual Dr.sc. Rafet Haxhaj, në çështjen përmbartimore të kreditorit K... ndaj debitorit të përmbartimit: S. K, me adresë në Komuna e Prishtinës, për kërkesën në të holla, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.752/2022 të datës 21.07.2023, me datë 27.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar, ankesa e debitorit S. K, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.752/2022 i datës 21.07.2023, PRISHET dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, refuzohet si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përmbartimit: S. K, me adresë Komuna e Prishtinës, i ushtruar kundër Urdhrit mbi Caktimin e Përmbartimit P.nr.282/22 të datës 23.06.2022 i Organit Përmbartues-Përmbartuesit Privat R. M.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit ligjor ankesë ka parashtruar debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa si e bazuar, aktvendimi i atakuar të ndryshohet apo i njëjti të priset dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, apo i njëjti të ndryshohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP, gjeti se:

Ankesa e është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se kreditori K... ka parashtruar propozimin për përmbaram ndaj debitorit S. K, lidhur me pagesën e borxhit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit nga librat afariste, për shumën 1,284.83€.

Me urdhrin për përmbaram P.nr.282/2022 të datës 23.06.2022 Përmbaruesi Privat R. M e ka caktuar përmbaramin e propozuar sipas propozimit për përmbaram të kreditorit, K..., kundër debitorit S. K.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbaramit të përmbaruesit privat, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim debitori, duke e kontestuar urdhrin për përmbaram, për shkak se kreditori nuk ka dëshmuar se faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarami janë dorëzuar debitorit, pra nuk ka asnjë provë se faturat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe është bërë shfrytëzimi i energjisë elektrike në shumën e cekur si në propozim për përmbaram. Tutje ka shtuar se, borxhi i referohet periudhës së pa definuar saktësisht pasi tek debitori nuk ka arritur asnjë faturë që dëshmon këtë, ndërsa propozimi për përmbaram është parashtruar me datë 22.06.2022, e që për të gjitha faturat e arritura mbas një viti sipas nenit 360 par.1.1 të LMD-së janë parashkruar.

Kreditori ka ushtruar përgjigje me shkrim në prapësimin e debitorit dhe ka kërkuar që të refuzohet prapësimi si i bazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri i përmbaruesit privat për caktimin e përmbaramit P.nr.282/22 të datës 23.06.2022.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk e miraton edhe gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë, për faktin se aktvendimi i atakuar me ankesë është përfshirë me shkelje esenciale nga neni 182.2 pika n) për arsye se thëniet në arsyetimin e vendimit të atakuar me ankesë janë në kundërshtim me atë që është e përmbajtur në shkresat e lëndës. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se si rezultat i këtyre që u than më lartë edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë dhe si rezultat i të gjitha këtyre edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar. Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se borxhi të cilin e kërkon kreditori është për periudhën 12.01.2021 deri me 17.06.2022, ndërsa në propozimin për përmbaram të kreditorit drejtuar Përmbaruesit Privat R. M në pjesën e parë të propozimit shuma e kërkuar nga kreditori është 1,284.83€ për periudhën 29.07.2017 deri me datë 11.06.2022. Gjyqtari i vetëm i gjykatës së shkallës së dytë gjen se në një gjendje të tillë të çështjes kur kreditori ka pretendime se debitori

nuk e ka përmbushur detyrimin ndërsa debitori ka pretendime se borxhi i referohet periudhës së pa definuar, dhe i njëjti është thirrur edhe në parashkrim, gjykata e shkallës së parë ka qenë dashur që në kuptim të dispozitës së nenit 73 të LPP-së të bëjë caktimin e seancës dëgjimore më qëllim të vërtetimit të lartësisë së borxhit nëse ekziston, dhe përcaktimi i periudhës për të cilën kërkohet borxhi. Për arsyet e cekura si më lartë gjyqtari i vetëm i Gjykatës së Apelit ka vlerësuar se qëndrojnë pretendimet e debitorit të parashtruara me ankesë dhe ka vendosur që aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Në procedurën e serishme gjykata e shkallës së parë udhëzohet që ti eliminojë të metat si më lartë, të caktojë seancën dëgjimore, të vërtetohet lartësia e saktë e borxhit që duhet paguar, të vërtetohet rrjedha e parashkrimit, dhe pas kësaj të vërtetojë nëse debitori ka apo nuk ka borxh për të përmbushur. Gjykata e shkallës së parë të marr parasysh edhe faktet e tjera relevante për vendosje në procedurë dhe pas vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe me aplikimin e drejtë të së drejtës materiale të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm në këtë çështje përmbartimore.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjykatësit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjykatësi individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par 1 pika c) të LPK-së lidhur me nenin 17 dhe 3.2 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E AELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1554/2023, me datë 27.03.2024

GJYKATËSI,
Dr.sc. Rafet Haxhaj